



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1199/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Srgjan Maksimoviqit kandidat për asamblenë komunale në Novo Bërd nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Srgjan Maksimoviqit kandidat për asamblenë komunale në Novo Bërd nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS).

URDHËROHET KQZ që të rinumëroj fletëvotimet në Qendrën e Votimit 1412D, vetëm sa i përket kandidatit të sipërsënuar dhe ky numërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të 3 Nëntorit 2013.

A R S Y E T I M


PZAP-i me datën 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Srgjan Maksimoviqit kandidat për asamblenë komunale në Novo Bërd nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS) në të cilën pretendon se në vendvotimet 1412D dhe 1412R janë numëruar votat për këshilltar dhe se sipas parashtruesit të ankesës ai ka pasur 71 vota duke qenë në listën e SLS-së me nr rendor 2 ndërsa nga rezultati zyrtar i KQZ-së thekson se i ka 44 vota. Parashtruesi i ankesës kërkon që të bëhet rinumërimi i votave për këtë vendvotim.

PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit gjeti se:

- **ankesa është e bazuar**

PZAP-i nga shkresat e lëndës të ofruara nga pala ankuese si dhe nga shqyrtimi dhe hetimi i bërë në materialin zgjedhor dyshon në mungesën e votave të kandidatit në fjalë në QV-në e lartcekur në dispozitiv dhe në mospërputhje të rezultateve me ato të publikuara nga KQZ për kandidatin në fjalë. PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në këtë qendër të votimit. Andaj PZAP nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
A nr. 1199/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankese në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i